

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
01	04/03/2025	Kërkoj informacion mbi: - Raport të të gjitha impianteve të përpunimit të ujërave të zeza, landfillleve të mbetjeve të ngurta dhe kushteve të funksionimit të tyre deri nga viti 2000 deri në vitin 2025 (specifikisht sipas secilit vit) -Çfarë angazhimesh konkrete janë marrë nga viti 2000 deri në vitin 2025 (specifikisht sipas secilit vit)për të garantuar pastërtinë e burimeve ujore dhe çfarë veprimesh janë marrë për të matur dhe garantuar cilësinë e ujit? -Raporte të matjes së cilësisë së ujrave nga viti 2000 deri në vitin 2025 (specifikisht sipas secilit vit). -Çfarë reformash u zbatuan për arritjen e standardeve mjedisore evropiane dhe cili ka qenë vlerësimi I këtyre përpjekjeve nga organet e pavarura mjedisore? Çfarë renditje mban Shqipëria në rang botëror për sa i përket cilësisë së mjedisit ajrit dhe ujit nga viti	15/05/2024	Përgjigje Nr 1: Të dhënat i gjeni në tabelën në Excel bashkëlidhur këtij emaili. Përgjigje Nr 2: Më poshtë gjeni të dhënat e viteve 2020-2024. Të dhënat e vitit 2025 jepen në mars të vitit 2026. Viti 2020 : Pyje Publikë :1,023,061 (Ha) Pyje Privatë : 28,780 (Ha) Gjithsej : 1,051,841 (Ha) Viti 2021 : Pyje Publikë :1,117,944 (Ha) Pyje Privatë : 28,780 (Ha) Gjithsej : 1,146,724 (Ha) Viti 2022 : Pyje Publikë :1,117,945 (Ha)	E plotë	Nuk ka

	2000 deri në vitin 2025 (specifikisht sipas secilit vit)? -A mund të tregoni në detaje masat e marra për ndalimin e përdorimit të vajit D2. Kur ka ndodhur ndalimi i tij, çfarë ndikimi ka pasur kjo në cilësinë e ajrit? -Si i ka monitoruar dhe matur qeveria nivelet e ndotjes në ajër nga viti 2000 deri në vitin 2025 (specifikisht sipas secilit vit)? Jeni të lutur të bashkangjisni kopje të këtyre raporteve sëbashku me rezultatet përkatëse. Ku janë të vendosur matësit e cilësisë së ajrit? -Çfarë hapash janë ndërmarrë për të përmirësuar cilësinë e ajrit dhe si maten ato? Kopje të rezultateve të tyre. -Çfarë të dhënash specifike disponohen në lidhje me reduktimin e eksporteve të lëndës drusore të papërpunuar dhe si ka ndikuar kjo në përpjekjet për ruajtjen e pyjeve? -Të dhëna mbi sipërfaqen pyjore të Shqipërisë nga viti 2000 deri në vitin 2025 (specifikisht sipas secilit vit). -A ka Shqipëria sot një inventar të pyjeve? Kur ka hyr në zbatim? Jeni të lutur të bashkangjisni të dhënat e këtij inventari. -Kopje të strategjisë kombëtare të hartuar për menaxhimin e qëndrueshëm	Pyje Privatë : 28,780 (Ha) Gjithsej : 1,146,725 (Ha) Viti 2023: Pyje Publikë : 1,117,945 (Ha) Pyje Privatë : 28,780 (Ha) Gjithsej : 1,146,725 (Ha) Viti 2024 : Pyje Publikë : 1,117,945 (Ha) Pyje Privatë : 28,780 (Ha) Gjithsej : 1,146,725 (Ha) Përgjigje Nr.3 : Inventari i fundit Kombëtar i Pyjeve dhe Kullotave në vendin tonë është bërë në vitin 2021. Të dhënat e këtij inventari i gjeni në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve (https://akpyje.gov.al/inventari-kombetar-i-pyjeve-dhe-kullotave-ikpk-2021/). Përgjigje Nr.4 : Sa më sipër, ju sqarojmë se Inventari Kombëtar i Pyjeve dhe Kullotave (IKPK) është një proces i projektuar për të siguruar informacion të saktë në nivel kombëtar në lidhje me: sipërfaqen e pyjeve, tipet e pyllit, shpërndarjen e tyre, përbërjen llojore, strukturën, volumin drusor të tyre. Ai nuk prodhon informacion në nivel		
--	--	---	--	--

	të pyjeve, duke përfshirë afatet kohore për zbatimin. -A është bërë ri-inventarizimit i pyjeve kombëtare. Nëse po, çfarë veprimesh janë ndërmarrë në bazë të këtij inventarizimi? -Çfarë programesh janë zhvilluar për pyllëzimin dhe si financohen dhe monitorohen? Jeni të lutur të bashkangjisni të dhënat e këtyre programeve. - Kopje të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të zonave të mbrojtura (ZM), Parqeve Kombëtare (PK), Rezervateve Natyrore Strikt (RNS). Kur u hartua ky plan? Kopje të rezultateve nga zbatimi i tij. -Çfarë nismash specifike janë ndërmarrë për të reduktuar përdorimin e qeseve plastik dhe si monitorohet efektiviteti i tyre?		parcele/ngastre/nëngastre apo ekonomie pyjore (ky informacion mbi bazë “ngastre/nëngastre” prodhohet nga plani i mbarështimit për çdo ekonomi pyjore).Të dhëna të tilla gjenerojnë vetëm planet e mbarështimit të ekonomive pyjore,si dokument bazë për zhvillimin e tyre. Përgjigje Nr.5 : Nga AKP për vitin 2023-2030 është hartuar Draft-Plani Kombëtar “Për mbjellje drurësh pyjorë dhe pyllëzime për periudhën 2023-2030” program që fokusohet në Pyllëzimin dhe ripyllëzimin si masa me efektive e rigjenerimit dhe shtimit te grumbujve pyjore ne tokat pa mundësi ripertëritje. Ky planifikim u parashikua të mbështetej me fondet e vetë bashkive dhe të donatorëve që deri tani nuk është realizuar. Nga ana e bashkive me fondet të gjenerura nga sektorit pyjor për vitin pyjor 2023-2024 janë ndërmarrë pyllëzime të sasive të vogla në ha. Gjithsej 44 ha ose 59 467 ha. Në vitin Shqiptar të Pyjeve 2024 për periudhën Dhjetor 2023 deri Mars 2025 janë ndërmarrë një sërë nismash për sensibilizimin mbi rëndësinë e mbjelljes së drurëve pyjore dhe në total gjatë kësaj periudhe janë raportuar një numër i konsiderueshëm drurësh apo pemësh dekorative në qendra urbane, shkolla, zona të eroduara apo parqe urbane, ku si synim kryesor ka qënë ndërgjesim/sensibilizimi në kuadër të “Vitet Shqiptar të Pyjeve 2024”. Në bazë të statistikave të grumbulluara nga AKP rezulton të jenë mbjellë 163 ha dhe	
--	--	--	---	--

				1,537,000 fidane drurë të llojeve të ndryshëm.		
02	22.03.2025	Po ju shkruaj për një kërkesë informimi mbi vendet vakante në njësinë tuaj. Do ta vlerësoja nëse më orientoni se ku mund të shoh për listën e vendeve të punës që ju publikoni.	28.03.2025	Lidhur me kërkesën tuaj për informacion mbi vendet vakante në institucionin tonë, ju informojmë se të gjitha shpalljet e vendeve të punës në Administratën Publike publikohen në portalin zyrtar të Departamentit të Administratës Publike. Për të qëndruar të informuar në kohë reale mbi shpalljet e reja ju rekomandojmë të vizitoni rregullisht seksionin "Shpalljet" për vendet vakante në https://www.dap.gov.al/dap	E Plotë	Nuk ka